

VENDIM
Nr. 216, datë 4.7.2023

**MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE,
LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE
DYNAMICS SHPK”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pikat 4, 5 dhe 6 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Memorandumin e mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 6.12.2021; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/4 prot., datë 29.6.2023, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, vazhduar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin ‘Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.’”,

konstatoi se:

- Subjekti “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, dega në Tiranë, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e datës 24.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2023, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për furnizimin me energji elektrike, me numër ZRRE/Li_55/16, të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023.

- Më herët, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.5.2022, ka miratuar njohjen e kësaj licence, dhënë me vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_968_2018, datë 13.4.2018.

- ERE me *e-mail*-in e protokolluar me nr. 1721/1 prot., datë 13.6.2023, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës kërkesën për informacion, në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- ZRRE Kosovë me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1721/3 prot., datë 27.06.2023, ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 4, dhe shtojca 1/K e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, deri më 12.4.2028.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/Li_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics

sh.p.k.”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, dega në Tiranë.

2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 është e vlefshme deri më 12.4.2028.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti